



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 531/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020,
- II. Akreditohet programi i studimit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 140 studentë për vit akademik.
- III. Nuk akreditoohen programet e studimit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”:
  - Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (0 – 3 vjeç), BA, 240 ECTS;
  - Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, MSc, 120 ECTS.
- IV. Obligohet Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- V. Obligohet Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim institucional dhe të programeve të studimit: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, BSc, 180 ECTS, Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (0 – 3 vjeç), BA, 240 ECTS, dhe Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	BSc	180	Fridrik Dulaj, Labinot Berisha, dhe Muharrem Gashi
2	Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (0 – 3 vjeç)	BA	240	Ilmi Hoxha, Januz Bunjaku, dhe Nexhmije Kastrati
3	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	MSc	120	Besim Muhadri, Kamber Kamberi, dhe Shaban Buza

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" më 18.04.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Dhurata Shehri dhe Rebecca Maxwell Stuart.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit, Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (0-3 Vjeç) BA, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Stafi akademik është problemi kryesor për programin e propozuar akademik. Sipas ekspertëve, edhe pse Universiteti i Gjakovës ka bërë përpjekje për të angazhuar staf të ri, rezultatet nuk janë të kënaqshme. Tre (3) bartësit e programit të studimit të cilët ishin prezent gjatë procesit të akreditimit e të cilët duhej të mbronin programin e studimit nuk ishin të profilizuar për programin e studimit për të cilin Universiteti ka aplikuar për akreditim. Sipas ekspertëve, lista zyrtare e stafit akademik e konfirmuar nga AKA po ashtu tregon qartë se vetëm 3 persona janë të kualifikuar me nivelin PhD dhe atë në shkencat e edukimit apo psikologjisë dhe vetëm njëri nga ta është me kontratë të rregullt. Ngjashëm vetëm 3 persona janë të kualifikuar me nivelin Master në fushën e shkencave të edukimit/ psikologjisë dhe përsëri vetëm njëri nga ta ka kontratë të rregullt. Sipas ekspertëve ndërkombëtarë kjo nuk është e mjaftueshme për akreditimin e një programi të ri.

Për sa i përket programit të studimit, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi MSc, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekipit të ekspertëve, stafi akademik nuk korrespondon me programin e propozuar. Çështja më problematike është që profesori i njëjtë ligjëron në 2-3 lëndë të ndryshme dhe janë profesorët e njëjtë të cilët ligjërojnë 5-6 lëndë të tjera në programin BA Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, dhe vetëm në raste të rralla aktiviteti i tyre shkencor është i lidhur me fushën që ata mbulojnë në programin Master. Në përgjithësi, sipas ekspertëve, aktiviteti shkencor i stafit akademik të Universitetit të Gjakovës është jashtëzakonisht i pazhvilluar.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

